

MONITORIMI I PASQYRIMIT TË FËMIJËVE NË GAZETAT E PËRDITSHME

SHTATOR 2007

Hyrja

Për të pasur një ide sa më të mirë për mënyrën se si media pasqyron dhe paraqet fëmijët, një raport monitorues për gjashtë gazetat kryesore u krye për të gjithë muajin shtator. Gazetat e përditshme përfaqësonin median kryesore dhe u përzgjedhën ato që mendohen se kanë edhe numrin më të madh të kopjeve të shitura. Meqë nuk ekzistojnë të dhëna zyrtare për shitjet e gazetave dhe tirazhin e tyre në përgjithësi, përzgjedhja e gazetave për monitorim u krye sipas konsultimeve me kryeredaktorët e të përditshmeve. Botimet e përditshme të përfshira në raportin monitorues ishin: *Shekulli, Panorama, Standard, Gazeta Shqiptare, Albania, Shqip*. Gjatë kësaj kohe u monitoruan të gjitha artikujt që kishin të bënin me ose përfshinin apo preknin fëmijët. Fëmijët në këtë rast upërkufizuan si personat nën 18 vjeç. Për të pasur një pamje sa më të plotë sa të jetë e mundur, artikujt që nuk përqendroheshin posaçërisht te fëmijët por kishin të bënin me ta, u morën gjithashtu parasysh.

Analiza e artikujve të monitoruar ishte si sasiore, ashtu edhe cilësore. Temat kryesore që dolën nga këta artikuj të monitoruar ishin kryesisht trafikimi i fëmijëve, dhuna në familje, arsimi, krimi dhe drejtësia për të miturit, etc. Numri i përgjithshëm i artikujve të monitoruar ishte 169 artikuj për të gjashtë gazetat. Artikujt e monitoruara nuk përfshinin vetëm lajmet, por edhe editorialet, reportazhet, lajmet e shkurtra, etj. Gjatësia e artikujve varioonte nga dy paragrafë në një faqe të tërë gazete, në varësi të lajmit që paraqiste. Në përgjithësi mund të thuhet se ka pasur një rritje në numrin e artikujve mbi fëmijët, ndoshta e lidhur dhe me faktin që shtatori është muaji kur nis shkolla dhe kjo është një temë që ka qenë e rëndësishme. Artikujt për këtë temë zinin një vend të spikatur në hapësirën e gazetave të monitoruara dhe përgjithësisht ishin të lidhura me ndonjë ngjarje që ishte zhvilluar atë ditë. Numri i artikujve për gazetë është si më poshtë:

Gazeta e përditshme	Numri i artikujve për fëmijët
Shekulli	23
Shqip	45
Panorama	26
Albania	21
Standard	21
Gazeta Shqiptare	33

Në përgjithësi, vërehej një lloj njëtrajtshmërie përsa i përket larmisë së temave mbi fëmijët të pasqyruara në gazetata e përditshme të monitoruara. Gjithashtu, në krahasim me monitorime të mëparshme në këtë fushë, kishte një larmi më të madhe temash, një interes më të madh për fëmijët dhe mbarëvajtjen e tyre, si dhe një zgjerim të zonës gjeografike të mbuluar nga këto tema.

Nëse përpiqemi të grupojmë temat kryesore në lidhje me pasqyrimin e fëmijëve, disa parime kryesore mund të vërehen në pasqyrimin e fëmijëve. Përsa i përket përmbajtjes, temat mund të grupohen në kategoritë e mëposhtme të gjera: krimi dhe viktimat te të miturit, arsimi dhe shëndetësia, si dhe dhuna në familje. Me pak përjashtime, nuk kishte reportazhe ose artikuj investigativë për aspekte të veçanta të jetës së fëmijëve. Në fakt, megjithë përmirësimet e bëra, numri i ulët i artikujve për fëmijët është tregues për përparësinë e ulët për pasqyrimin e këtij grupi në gazetata e përditshme. Një tipar tjetër që duhet parë në këtë aspekt është edhe motivimi për artikujt e botuar, domethënë komunikatat për shtyp, ngjarjet, ose raportet e nxjerra nga qeveria, nga organizata joqeveritare, apo nga ato ndërkombëtare. Po kështu, përdorimi i intervistave dhe citateve të fëmijëve, si dhe fotot dhe faqosja, kanë rolin e tyre në krijimin e një pamjeje më të plotë të llojit të pasqyrimin mediatic për fëmijët në gazetata e përditshme. Meqë këto janë disa nga tiparet mbizotëruese në pasqyrimin e përgjithshëm të fëmijëve në gazetata e përditshme, do të ishte e dobishme studimi më i thellë i tyre, në mënyrë që të kemi një pamje sa më të plotë të raportimit të fëmijëve në përgjithësi.

Identifikimi i të miturve

Ky është një aspekt i gazetarisë që mbetet gjithnjë i diskutueshëm, edhe pse ka pasur përmirësime të ndjeshme në krahasim me përvojën e viteve të shkuara. Përvoja e monitorimit të gazetave për muajin shtator ka treguar se në përgjithësi këto gjashtë gazeta nuk i identifikonin të miturit me emër të plotë. Përjashtime bënë rastet e veçanta si vdekjet e të miturve (rasti i helmimit në Vlorë, aksidentet e ndryshme). Sidomos në rastet e krimeve, atëherë kur është dhe më i ndjeshëm identifikimi, në përgjithësi përdoren inicialet. Megjithatë duhet pasur parasysh se edhe pse në pamje të parë duket sikur nuk ka probleme në këtë aspekt, hollësitë e mëtejshme shfaqin disa probleme në lidhje me identifikimin.

Kështu, jo rrallë krimet ose episodet e ndjeshme që përfshijnë të miturit, ndodhin në komunitete shumë të vogla, ku të gjithë njihen me njëri tjetrin. Kështu që në këtë rast edhe dhënia e inicialeve e bënë të miturin viktimë apo të dyshuar lehtësisht të identifikueshëm. Aq më tepër që ka edhe raste kur nuk përmenden vetëm inicialet, por inicialja e emrit dhe mbiemri, moshë, madje në disa raste dhe emrat e prindërve. Dhënia e të gjitha këtyre detajeve, në kontekste të komuniteteve të vogla, nuk lë asnjë dyshim për identifikimin e të miturve në këto episode. Për shembull, në artikullin “Gjimnazisti plagos pas grindjes shokun e klases,” thuhet se A.Gjapi, 15 vjeç, është sulmuar me thikë nga I.Sula, shoku i tij i klasës, në një gjimnaz të Peshkopisë.

Një rast tjetër është ai i artikujve për djalin e humbur, i cili u gjend nga një çoban dhe nuk mund të identifikohet. Pasi erdhën të afërmit, djali u identifikua dhe bashkë me të edhe prindërit, duke u dhënë gjithashtu informacioni se prindërit janë të sëmurë psikikë, prandaj nuk ishin kujdesur për djalin.¹ Në këtë rast është e paqartë se cili është interesi publik në shfaqjen e problemeve të kësaj familjeje.

Një rast akoma më i rëndë është ai i një incesti të dyshuar në një fshat të Mallakastrës, ku dyshohej se nëna e kishte shtyrë të bijën të denonconte të atin. Vajza identifikohet si 13-vjeçarja S.Hoxha dhe i ati ishte Azem Hoxha. Gjithashtu thuhet se vajza është nxënëse e klasës së gjashtë në shkollën e fshatit ku banon, në Lapulec.² Pra me këto të dhëna vajza është lehtësisht e identifikueshme nga komuniteti që e rrethon, duke i shtuar situatës së saj të vështirë edhe probleme të tjera për të përballuar.

Një tjetër rast që ka të bëjë me identifikimin e të miturve është ai i lidhur me qendrën e aftësimin në Korçë, ku personeli akuzohej për keqtrajtim ose abuzim të disa prej personave me aftësi të kufizuara, disa prej të cilëve ishin të mitur. Ndërkohë që problematika e qendrës ia vlente dhe duhej ngritur në gazetë, është e paqartë se cili ishte interesi publik kur shohim se janë botuar disa foto të fëmijëve ose personave që frekuentonin këtë qendër.

Problemet e fëmijëve dhe personat publikë

Siç pritej, fëmijët rrallë janë në qendër të artikujve të monitoruar. Në vend të tyre, janë të rriturit gjithnjë ata që flasin në emër të fëmijëve, qofshin këta prindërit, përfaqësuesit e qeverisë, aktivistë të të drejtave të njeriut, ekspertë të ndryshëm, etj. Si e vë në dukje dhe Mike Jempson: “Pasqyrimi i fëmijëve rrallë është pjesë e trajnimit profesionist të gazetarëve, pasi në përgjithësi gazetarët merren me tema për të rritur, në një botë të rriturish, për një publik të rriturish.”³

Në fakt, për jetët e fëmijëve të zakonshëm rrallë përshkruhet apo hetohet në faqet e këtyre gazetave. Një arsye për këtë mund të jetë vetë natyra e këtyre botimeve, të cilat rrallë përfshijnë reportazhe, por në përgjithësi kanë vetëm lajmet e ditës. Siç mund të pritët, fëmijët rrallë janë në qendër të artikujve të monitoruar. Në vend të tyre, janë të rriturit gjithnjë ata që flasin në emër të fëmijëve, qofshin këta prindërit, përfaqësuesit e qeverisë, aktivistë të të drejtave të njeriut, ekspertë të ndryshëm, etj.

Pra, është një sfidë e vërtetë të gjesh artikuj si këta më sipër, ku fëmijët janë të cituar dhe artikulli është për fëmijët. Ajo me të cilën lexuesi ndeshet shumë kollaj është prania ose prononcimet e qeveritarëve ose aktivistëve të të drejtave të njeriut, të cilët flasin për fëmijët; nëse e bëjnë diçka të tillë në emër të tyre apo jo, kjo lë vend për diskutim. Në mënyrë më specifike, ngjarje të tilla si dalja e një raporti për fëmijët, festimi i një

¹ “12-vjecari i humbur rikthehet në shtëpi,” Albania, 29.09.2007, f.18.

² “Nëna shtyn të bijën që të deklarojë incestin,” Shqip, 05.09.2007, p.21.

³ Jempson, Mike. “Slander, sentimentality or silence? What young people have to put up with from the media,” f.2, I cituar në http://ëëë.mediaëise.org.uk/display_page.php?id=896

përvjetori të fshatit për fëmijët në nevojë, ose ndonjë ngjarje tjetër si këto, përbëjnë gjithnjë lajm, të shoqëruara me prononcimet përkatëse të politikanëve të përfshira në to, duke nisur nga Presidenti, Kryetarja e Parlamentit, Ministri i Arsimit, Ministri i Drejtësisë, Kryetari i Bashkisë së Tiranës, etj.

Ngjarje të tilla ishin mjaft të dukshme me fillimin e vitit akademik ose edhe ditë më vonë, pasi politikanët dhe personalitete të tjera, përveç fëmijëve, ishin gjithashtu mjaft të pranishëm në këto ditë. Për shembull, nëse shohim dy gazeta të datës 14 shtator, si Standard,⁴ ashtu edhe Gazeta Shqiptare⁵ kishin artikuj për shpërndarjen e paketave didaktike nga ana e bashkisë për fëmijët e varfër. Padyshim që kjo është një nismë e lavdërueshme, por të dy artikujt kanë botuar paragrafe të gjatë të fjalimit që mbajti kryetari i bashkisë në këtë rast, së bashku me emrat e të gjitha organizatave që ndihmuan në këtë nismë. Megjithatë, as edhe një fjalë nuk përmendet ose nuk vjen nga vetë fëmijët, të cilët janë ata që përfitojnë drejtpërdrejt nga kjo nismë.

Po kështu, një artikull tjetër përshkruan pjesëmarrjen e kryebashkiakut Edi Rama në përirimin e rikonstuksionit të një kopshti⁶. Artikulli shpenzon disa paragrafë për të dhënë statistikat e fondeve të asistencës që bashkia ka përdorur për të rinovuar këto kopshte, përmirësimet e detajuara që janë bërë, si dhe fjalën e kryebashkiakut në atë rast. Sërish, edhe pse janë jetët e fëmijëve që përmirësohen ndjeshëm në këtë rast, as edhe një zë nuk vjen nga ana e tyre për të folur për këtë temë.

E njëjta praktikë përdoret edhe në raste të tjera, në artikuj të tjerë. Një që mund të përmendet në këtë aspekt është artikulli i shkurtër për një deputet që kish vendosur të mbështeste financiarisht 35 jetimë të zonës së tij dhe të ofronte një bursë për studentin më të mirë. Artikulli⁷ jep detaje për këtë nismë, për fondacionin që e mbështet atë, për arsyet e deputetit që të merrte një nismë të tillë, të thëna me fjalët e tij, por siç ndodh rëndom, fëmijët, jeta e të cilëve mund të ndryshojë tërësisht nga kjo nismë, mungojnë krejt.

Një rast akoma më flagrant i kësaj prirjeje është artikulli për kompaninë që drejton minierën e Bulqizës, ku një sërë aksidentesh kanë sjellë vdekjen e disa minatorëve. Artikulli⁸ dëshmon për vendimin e kompanisë për t'u lidhur një pension fëmijëve të minatorëve të vdekur, derisa ata të mbushin moshën për punë. Ky vendim, si dhe arsyet që u mor ky vendim janë të shpjeguara shkurtimisht në një paragraf të shkurtër. Pjesa tjetër e artikullit vazhdon të informojë për ndryshimin e aksionerëve brenda kompanisë, historinë e koncesionit, shtrirjen e kësaj kompanie në Shqipëri dhe shpresat për të ardhmen. Shkurtimisht, artikulli ka formën tipike të një komunikate për shtyp, ku kompania është protagonistja e vetme. E kotë të thuhet, fëmijët nuk duken gjëkund, pasi historia, bujaria dhe investimet e ardhshme të kompanisë kanë zënë vendin e tyre, edhe pse artikulli supozohet të jetë për fëmijët.

⁴ “Bashkia Tiranë dhuron mjete shkollore për 200 nxënës të ‘Vasil Shantos’”, 14.09.2007, f.11.

⁵ “Bashkia shpërndan paketa didaktike për fëmijët e varfër,” 14.09.2007, f.13.

⁶ “Përirimi i kopshtit, Rama: T’i afrohemi standarteve europiane,” Shekulli, 13.11.2007, f.11.

⁷ “Neraxhi, ndihma për fëmijët e Krrabës,” Panorama, 13.09.2007, f.4.

⁸ “‘Darfo’, pension 14 fëmijëve të viktimave të Bulqizës,” Standard, 18.09.2007, f.6.

Ndërsa prania e politikanëve, bizneseve, apo aktivistëve në artikuj nuk mund të gjykohet dhe është padyshim një shenjë e mirë që zyrtarë të rangut të lartë janë të përfshirë në këto kauza të rëndësishme, prania e tyre është pa dyshim e shpërpjestuar në krahasim me atë të vetë fëmijëve, të cilët përbëjnë edhe fokusin e këtyre artikujve. Asnjë nga artikujt e botuar në këtë aspekt nuk përfshin ndonjë fëmijë apo reagimin a përvojën e tyre në lidhje me problemet e paraqitura.

Larmia e temave të pasqyruara

Ky monitorim ka shënuar një pasqyrim më të larmishëm në spektrin e temave që prekin fëmijët, sidomos duke e krahasuar edhe me monitorime të mëparshme të kësaj teme po te gazetat e përditshme. Arsimi, shëndetësia, drejtësia dhe krimet e të miturve, fëmijët e rrugës, si dhe probleme të tjera të shumta me të cilat fëmijët përballen, shfaqen në të gjitha gazetat e përditshme, në disa më shumë se në të tjerat.

Një nga temat më të pasqyruara ka qenë ajo e arsimit, problemet me infrastrukturën e tij, si dhe aspekte të tjera. Arsyeya kryesore për shpeshësinë e artikujve për këtë temë ka qenë dhe fillimi i vitit shkollor në shtator dhe probleme të tjera që e pasuan në tetor.

Shumica e artikujve për këtë temë është e lidhur me mungesën e kushteve të përshtatshme në shkolla dhe kopshte, si dhe me probleme të tjera, të lidhura ose jo me shkollën. Shumica e gazetave përmbanin jo thjesht artikuj të shkurtër përshkruar për ditën e parë të shkollës, por edhe reportazhe prej dy faqesh për fillimin e vitit shkollor, duke u përqendruar sidomos te klasa e parë apo te problemet e reja dhe të vjetra.

Ndërkohë që shumica e problemeve të trajtuara (infrastruktura e keqe e shkollës, shpenzimet e larta për prindërit, mungesa e teksteve, etj) ishin të njohura për lexuesin, kishte dhe një temë tjetër ku gazetat rrallë përqendrohen, ajo e fëmijëve të ngujuar për shkak të gjakmarrjes, të cilët nuk mund të shkonin në shkollë si bashkëmoshatarët e tyre. Kështu, një artikull i botuar në Panorama trajton këtë problem, duke dhënë shifra zyrtare për këtë problem ende të pazgjidhur. Artikulli thotë se ka 67 fëmijë të izoluar dhe rreth 350 nxënës në rrethin e Shkodrës që nuk mund të ndjekin mësimin, pasi janë të ngujuar.⁹

Një artikull tjetër¹⁰, i botuar në Shqip, përveç shifrave i sjell lexuesit edhe një shembull konkret dhe fytyrën njerëzore të një vajze 6-vjeçare, e cila e vuan këtë problem. Artikulli boton një foto nga afër të vajzës. Edhe fjalia hapëse e artikullit tregon se si vajza ndenji një orë në dritare, duke parë bashkëmoshatarët që shkonin për herë të parë në shkollë, ndërkohë që ajo nuk mundej. Fotoja, intervista me vajzën, përshkrimet, e sjellin problemin dhe dhimbjen e këtyre fëmijëve më pranë lexuesit, duke e bërë tërë temën më të lehtë për t'u kuptuar. Për më tepër, artikulli ka edhe një artikull shoqërues me shifra të detajuara dhe studime për këtë problem, gjë që i jep edhe më shumë besueshmëri të gjithë artikullit dhe e bën paraqitjen e problemit më të plotë.

⁹ “Shkodër, gjakmarrja mban pas pragut te shtepise 67 femije,” 25.09.2007, f.14.

¹⁰ “Shkodër, gjakmarrja mban 122 fëmijë larg shkollave,” 18.09.2007, f.6.

Një reportazh më i zgjeruar për nxënësit e klasës së parë që nuk vajtën dot në shkollë është dhe ai i botuar në Standard për ditën e parë të shkollës. Artikulli fokusohet jo vetëm te fëmijët që nuk nisin shkollën për shkak të gjakmarrjes, por edhe te ata që nuk shkollohen për shkak të problemeve të tjera. Hapësirë i kushtohet edhe fëmijëve që nuk shkojnë në shkollë se punojnë në një moshë kaq të njomë, duke sjellë një shembull konkret, një intervistë me një fëmijë fatkeq që punonte për të mbajtur familjen dhe nuk mund të shkonte në shkollë. “Edhe pse ka qejf të kthehet në shkollë, jeta nuk i merr parasysh dëshirat e këtij fëmije dhe e ka detyruar të rritet para kohe, duke i vënë përsipër përgjegjësi të mëdha për moshën.”¹¹ Në këtë mënyrë, edhe pse raportimi priret të bëhet sentimental në disa raste, përsëri arrin të sjellë fytyra njerëzore dhe zërat e fëmijëve te lexuesi, me problemet dhe gëzimet e tyre, duke e bërë pamjen më të plotë e të vërtetë.

Përveç kësaj, vëmendje u kushtohet edhe fëmijëve të pakicave etnike në jug të vendit. Kështu, Shqip kishte një artikull me titull “Shkollat e minoritetit grek, mësojnë me tekste shqip,”¹² i cili informonte për mungesën e teksteve në gjuhën greke. I njëjti problem u pasqyrua dhe në Panorama, së bashku me një artikull për problemet që gjimnazistët maqedonas po kalonin në një zonë tjetër.¹³ Në këtë mënyrë, duket sikur ka përpjekje më të mëdha nga gazetatat të pasqyrojnë akoma më shumë tema në lidhje me arsimin si dhe të pasqyrojnë pjesë më të madhe të territorit dhe popullsisë, si në aspektin gjeografik, ashtu edhe atë social.

Kjo gjë është gjithashtu e dukshme në artikuj të tjerë, të cilët kanë të bëjnë sidomos me problemet e infrastrukturës së sistemit të arsimit. Për shembull, artikuj të tjerë të botuar diën e parë të shkollës qenë: “Dibër, 50,000 nxënës nisin shkollën pa tekste,”¹⁴ “Saranda, dita e parë verifikon mungesën e teksteve,”¹⁵ “Elbasan, mësuesit e klasës së parë me 5 abetare në duar,”¹⁶ “Shkolla e re nuk ka as banja, nxënësit bojkotojnë mësimin,”¹⁷ “Fier, shumica e shkollave ende nën konstruksion,”¹⁸ etj. Këta artikuj të shkurtër, por informativë, përpiqen të ndërtojnë një mozaik pamjesh nga zona dhe probleme të ndryshme.

Përfundimet

Në përgjithësi, mund të thuhet se dalngadalë problemet e fëmijëve po fillojnë të shfaqen në faqet e gazetave shqiptare, në disa më shumë se në disa të tjera. Megjithatë, pasqyrimi i fëmijëve në media është ende larg të qenit i rregullt, sistematik, i përthelluar, apo tërësisht etik. Përpjekjet për të pasqyruar fëmijët dhe për t’u dhënë atyre një zë të vërtetë dhe vendin që meritojnë janë ende mjaft të kufizuara, për arsye të ndryshme. Në vend të kësaj, organet shtetërore, politikanët dhe OJF-të janë ata që flasin për fëmijët.

¹¹ “Zilja e parë e shkollës, jo për të gjithë,” Standard, 18.09.2007, f10-11.

¹² Shqip, 18.09.2007, f.6.

¹³ “Bojkotojnë gjimnazistët e minoritetit maqedonas,” Panorama, 19.09.2007, f.22.

¹⁴ Shqip, 18.09.2007, f.6.

¹⁵ Ibid.

¹⁶ Ibid.

¹⁷ Shqip, 19.09.2007, f.22.

¹⁸ Ibid.

Për fat të keq, edhe pse çështjet etike padyshim janë përmirësuar në krahasim me disa vite më parë, kronika e zezë vazhdon të mbetet një magnet për shtypin. Në frymën e përgjithshme që ka pushtuar botimet e përditshme, ku kronika e zezë është mbizotëruese dhe pasqyrimi i saj në përgjithësi është sensacional, artikujt ku të miturit janë viktime ose kriminelë nuk mund t'i shpëtojnë kësaj prirjeje.

Një tjetër prirje që mund të vihet re në pasqyrimin e të miturve në median shqiptare është ajo i marrjes së tyre nën mbrojtje. Ndërkohë që ka një numër në rritje të artikujve që tregojnë se gazetarët kanë marrë përsipër të ndihmojnë një kauzë apo një rast të veçantë, kufiri midis ruajtjes së dinjitetit të të miturve dhe ndihmës për ta mbetet mjaft i paqartë.

Rekomandime për përmirësimin e pasqyrimit të fëmijëve në media

- Gazetarët duhet të rrisin pasqyrimin e fëmijëve në media dhe ta zgjerojnë atë edhe me analiza të gjendjes së fëmijëve në shoqëri;
- Gazetarët duhet të reflektojnë mbi dilemat etike të intervistimit të fëmijëve si dhe për rrethanat e intervistës;
- Gazetarët duhet t'i trajtojnë fëmijët si gjithë njerëzit e tjerë dhe jo në mënyrë paternaliste, sensacionale, viktimizuese, apo shfrytëzuese;
- Duke pasur parasysh gjithë kujdesin që duhet treguar kur trajton fëmijët, gazetarët duhet të përpiqen të rrisin praninë dhe vizibilitetin e fëmijëve në media;
- Gazetarët duhet të tregojnë vëmendje të veçantë gjuhës dhe termave të përdorur, sidomos kur pasqyrohet krimi dhe drejtësia për të mitur;
- Media duhet të përmirësojë dhe të punojë më shumë në drejtimin e përdorimit të fotove, arkivave të pamjeve dhe diçiturave;
- Gazetarët duhet të përpiqen të përfshijnë ekspertët mbi fëmijët dhe mendimet dhe të dhënat e tyre më shpesh;
- Gazetarët gjithnjë duhet të kenë parasysh përkufizimin e interesit publik të Kodit të Etikës kur marrin vendime për të intervistuar fëmijët dhe për të botuar informacion rreth tyre.